



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.11.2023, ora 15:00

Drejton mbledhjen (online):

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikat e zhvillimit””
2. Diskutime për të ardhurat e planifikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”
3. Diskutime për shpenzimet e planifikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Shpresa Marnoj, Erion Braçe, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Vullnet Sinaj, Frrok Gjini, Milva Ekonomi, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Alban Xhelili, Sorina Koti, Jorida Tabaku, Ilir Topi, Ilir Metaj dhe Mimi Kodheli.

Mungojnë:

Agron Shehaj, Dashamir Shehi, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Xhelal Mziu, dhe Petrit Doda.

Të ftuar:

Ervin Mete - ministër i Financave dhe Ekonomisë

Adela Xhemali - zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Kesjana Halili – drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica - drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – drejtore e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Etugert Llazi – drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi – drejtor i Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi - Ritakohemi për të vijuar mbledhjen.

Meqenëse është kuorumi, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Në rendin e ditës së sotme kemi shqyrtimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit "Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikën e zhvillimit"". Relatore kemi zonjën Enslemvera Zake.

Po ashtu në rendin e ditës kemi diskutime për të ardhurat e planifikuara në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2024", si dhe diskutime për shpenzimet e planifikuara në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2024". Relatore janë zonja Blerina Gjylameti dhe zonja Antoneta Dhima.

Për pikën e parë të rendit të ditës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi ftuar zonjën Adela Xhemali, zëvendësministre, zonjën Kesjana Halili, drejtore e Përgjithshme, dhe zonjën Elona Mistrovica, drejtore.

Pa humbur kohë do t'i jap fjalën zonjës Xhemali.

Adela Xhemali – Përshëndetje!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e programit "Aftësia e parë ripërtëritëse dhe zhvillimi gjelbër - hua për politikën e zhvillimit", që mundëson financimin, nëpërmjet një kredie në formën e mbështetjes buxhetore nga Banka Botërore, në shumën 110,8 milionë euro. Si rrjedhojë e goditjeve të njëpasnjëshme, qeveria ka përparuar me një agjendë reformash, në kuadër të rritjes së qëndrueshmërisë së vendit, ndaj goditjeve të ardhshme, duke e vendosur fokusin në një trajektore zhvillimi më të gjelbër dhe më të qëndrueshme në përputhje me aspiratat dhe vizionin e vendit për anëtarësimin në BE.

Objektivat e këtij programi janë: forcimi i qëndrueshëm i sektorëve; forcimi i kuadrit të tregut të energjisë, si dhe rritja e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë; mbrojtja e mjedisit dhe minimizimi i ndikimit të ndryshimeve klimaterike. Kjo përbëhet nga tri shtylla: shtylla e parë mbështetet zgjerimin e bazës tatimore për kthimin e mekanizmave për zbutjen e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, përmirësimin e qëndrueshmërisë

së investimeve publike nga ndryshimet klimaterike dhe rritjen e efektivitetit të programeve të ndihmës sociale; shtylla e dytë mbështet rritjen e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme dhe eficiencën e përdorimit të energjisë në sektorin publik; shtylla e tretë mbështet legjislacionin e ri për të minimizuar ndotjen, si dhe rregulloret për të vendosur një mekanizëm monitorimi, raportimi dhe verifikimi për gazrat serrë. Siç kuptohet, këto reforma janë bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit. Këto reforma kanë marrë trajtë nëpërmjet miratimit të ligjeve të rëndësishme, si ai i tatimit mbi të ardhurat, ligji për energjinë e rinovueshme, amendimi i ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe nga një sërë aktesh nënligjore, që rregullojnë këto fusha.

Programi përbëhet nga një seri prej dy kredish për politika zhvillimi të ndërlidhura me njëra-tjetrën, që kanë në fokus rritjen e qëndrueshmërisë së ekonomisë dhe të zhvillimit të gjelbër, siç e përmenda dhe pak më parë.

Sikurse e përmenda dhe në fillim, kjo kredi vjen në formën e mbështetjes buxhetore, pra shkon e tëra për financimin e përgjithshëm të buxhetit të shtetit dhe deficitit të përgjithshëm, sigurisht kjo është një kredi nga Banka Botërore, pra është me terma koncesionarë, që janë goxha më të lehta se termat tregtarë.

Termat janë konkretisht: maturim prej 18 vjetësh, duke përfshirë një pagesë principali prej 5 vjetësh dhe një interes të përcaktueshëm mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit, bazuar në normën referencë euribor, me një marzh fiks prej 1,17%, gjithashtu një tarifë menaxhimi prej 0,25 % të huas.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Fjala për relatoren, zonjën Zake.

Enslemvera Zake – Faleminderit!

Projektligji për të cilin jemi mbledhur sot "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikën e zhvillimit", vjen si propozim i Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin "Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë". Në aspektin formal është në mbështetje të Rregullores së Kuvendit dhe të Kushtetutës, ndërsa në aspektin procedural ne, si komision, e shqyrtojmë në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër – hua për politikën e zhvillimit”, që do të mundësojë financimin e programit të mësipërm nëpërmjet akordimit të një huaje, në shumën 110 milionë e 800 mijë euro. Kjo kredi është në formën e mbështetjes buxhetore, pra do të shkojë për financimin e përgjithshëm të buxhetit të shtetit dhe deficitit të përgjithshëm të tij.

Për përballimin e tre vjetëve të vështira që ka pasur qeverisë shqiptare i është dashur që të ndërmarrë një sërë masash me karakter ekonomik dhe social, si pasojë e tre goditjeve që shkaktuan tërmeti, pandemia globale, si dhe lufta në Ukrainë. Këto masa janë financuar pjesërisht nga rritja e të ardhurave qeveritare dhe pjesërisht nga rialokimi i shpenzimeve të tjera publike.

Pra, në agjendën e qeverisë, e cila është mbështetur nga financimi i politikave të zhvillimit, ka të bëjë me krijimin e një ekonomie më ripërtëritëse, që zgjerohet drejt energjisë së rinovueshme dhe që i trajton në kohë shqetësimet mjedisore, prandaj mbështetja që vjen nga ana e Bankës Botërore, në bashkëpunim edhe me partnerët e tjerë të zhvillimit, është mjaft e dobishme në këtë drejtim, sepse edhe në këtë rast kredia që të gjenerohet nga Banka Botërore, ashtu si dhe kreditë e tjera të mëparshme të përfituara, do të jetë në kushte relativisht më të buta dhe më të favorshme se kreditë e tjera tregtare. Pra, do të jetë me terma financiarë më të favorshëm se termat që mund të merren nga një huamarrje alternative në tregun financiar të brendshëm apo edhe atë të huaj, dukshëm është edhe më e leverdishme për financat publike në raport me format e tjera alternative të financimit. Por, gjithashtu, nga ana tjetër, në këtë operacion të parë financiar fokusi primar i masave reformuese, që kushtëzohen për fitimin e kësaj kredie nga Banka Botërore, do të jenë kryesisht ndryshimet e nevojshme ligjore, që do të jenë të domosdoshme për progresin në lidhje me tri aspekte kryesore, siç janë: forcimi dhe rritja e kapaciteteve të energjisë, kryesisht të energjisë së rinovueshme; programet e ndihmës sociale, si dhe minimizimi i dëmeve në mjedis nga përdorimi i karbonit apo edhe nga ndikimi i ndryshimeve klimaterike.

Sa u përket aspekteve financiare apo efekteve financiare në buxhetin e shtetit, ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, ndërsa termat financiarë të kësaj kredie janë në vlerë shuma e huas është 110,8 milionë euro, interesi është i bazuar në normën e referencës së euriborit plus marzhin e pandryshueshëm 1,17%; tarifa *front*

and është 0,25% e shumës së huas dhe komisioni i angazhimit është 0,25%, që përlogariten mbi vlerën e padisbursuar të huasë. Koha e maturimit është 18 vjet, duke përfshirë në një periudhë prej 5 vjetësh për pagesë principali. Kjo është një kredi në terma reference favorizuese, sepse është një kredi koncesionare dhe nuk u referohet kredive të tjera në tregun europian apo tregun e brendshme, që kanë terma të tjerë reference huaje dhe me norma më të larta interesi. Kështu që, i ftoj kolegët deputetë për ta miratuar këtë projektligj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – A ka pyetje nga deputetët? Nuk ka pyetje. Atëherë, kalojmë në votim.

Projektligji ka dy nene. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Ju lutem, Arbi, Mimi! Kanë ngritur dorën zoti Braçe, zonja Marnoj, zonja Milva Ekonomi, zoti Frrok Gjini, zonja Enslemvera Zake, zonja Blerina Gjylameti, zonja Antoneta Dhima, zoti Ilir Topi, zoti Alban Xhelili.

Arbi Agalliu – Nuk marr pjesë në votim, zoti Shalsi.

Eduard Shalsi – Miratohet projektligji në parim.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zonja Xhemali!

Sekretare e Komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.11.2023, ora 15:00

Drejton mbledhjen (online):

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutime për të ardhurat e planifikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”

Diskutime për shpenzimet e planifikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Shpresa Marnoj, Erion Braçe, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Vullnet Sinaj, Frrok Gjini, Milva Ekonomi, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Arbi Agalliu, Alban Xhelili, Sorina Koti, Jorida Tabaku, Ilir Topi, Ilir Metaj dhe Mimi Kodheli.

Mungojnë:

Agron Shehaj, Dashamir Shehi, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Xhelal Mziu, Emilja Koliqi dhe Petrit Doda.

Të ftuar:

Ervin Mete - ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Etugert Llazi – drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi – drejtor i Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Eduard Shalsi - Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës. Elvi, kush do të na bashkohet?

Elvi Prifti - Këtu është ministri, pjesa e diskutimit për të ardhurat.

Eduard Shalsi – Kalojmë te diskutime për të ardhurat e planifikuara në projektligjin “Për buxhetin e viti 2024”.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Ervin Mete –Faleminderit!

Për vitin 2024 të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë në 675 miliardë lekë, nga këto të ardhurat tatimore 634 miliardë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mbliidhen nga tatimet dhe doganat 447 miliardë lekë.

Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet për sigurimin shoqëror dhe sigurimin shëndetësor planifikohen të jenë 157 miliardë lekë.

Në vijim të kërkesës suaj, ju kemi nisur dhe një sërë grafikësh se si kanë lëvizur të ardhurat në vite. Nëse shohim në krahasim me një dekadë praktikisht ne kemi dyfishim të të ardhurave totale në një dekadë, ku në vitin 2013 të ardhura totale kanë qenë 327 miliardë dhe tani janë 647 miliardë.

Krahasuar me të pritshmin e vitit 2023, të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit rriten 25 miliardë lekë, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet, doganat dhe kontributet pa marrë në konsideratë të ardhurat *one off*, pra *windfall taks* e energjisë, e cila zbatohet vetëm një herë në vitin 2023, programohen të rriten me 8,25% ose 47 miliardë lekë.

Të ardhurat tatimore dhe doganore, përfshirë kontributet e sigurimeve, janë projektuar bazuar në analizën e trendit historik shumëvjeçar të tyre, realizmin e pritshëm të vitit 2023 dhe të faktorizimit të të gjitha elementeve, që do të ndikojnë në të ardhurat e vitit 2024, përfshirë rritjen ekonomike, indeksin e çmimeve, si dhe të ardhurat shtesë nga miradministrimi apo nga politikat fiskale, që hyjnë në fuqi vitin e ardhshëm. Ky parashikim është analizuar dhe korrektuar me efektet e mundshme të faktorëve të tjerë relevantë, përfshirë koeficientet e elasticitetit, tipologjinë e çdolloj tatimi takse për të arritur, sipas kësaj metodologjie, në vlerësimin që ju paraqitet.

Në lidhje më të ardhurat nga tatimet, doganat dhe kontributet, më konkretisht të ardhurat nga TVSH-ja parashikohen të jenë rreth 211,2 miliardë lekë ose 11,7 miliardë lekë më shumë se pritshmëria e vitit 2023 nga afro 6% më shumë.

Burimet e rritjes së TVSH-së për vitin 2024 janë: rritja e të ardhurave, që gjenerohet nga rritja ekonomike dhe indeksi i çmimeve, dhe përmirësimi i administrimit të TVSH-së, duke u bazuar edhe në sistemin e fiskalizimit dhe të konsolidimit të faturimit elektronik.

Të ardhurat nga tatimi i fitimit korporativ parashikohen 83,7 miliardë lekë, me një rritje prej 3,7 miliardë ose 7,5%, krahasuar me të pritshmin e vitit 2023. E theksoj kjo është e zhveshur nga faktorët *one off*, pra taksa e veçantë mbi prodhuesit e energjisë elektrike.

Të ardhurat nga akciza parashikohen në total 63,6 miliardë lekë, 4,6 miliardë lekë më shumë ose 7,8% më shumë se sa i pritshmi i vitit 2023 dhe faktorët kryesorë në parashikimin e të ardhurave nga akciza lidhen me rritjen e nivelit të akcizave për shkak të indeksimit dhe zbatimit të skemës së rritjes së akcizës për cigaret, çka ndjek kalendarin e akcizës, rritjen e sasive të importit të prodhimit vendas dhe konsumit më mallrave, të karburanteve, cigareve, pijeve alkoolike, edhe kjo për shkak të rritjes së sasive, ndikuar edhe nga fluksi i turistëve në vend.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale parashikohen në masën 65, 2 miliardë lekë, me një rritje prej 9,2 miliardë ose 16,4% më shumë se i pritshim i vitit 2023, ku efekt në këtë rritje ka edhe reforma e pagave, rritje e cila pritet të gjenerojë të ardhurat shtesë edhe nga tatimi mbi pagat.

Gjithashtu, në këtë kuadër hyjnë edhe masat e reja, që fillojnë nga ligji i ri i tatimit mbi të ardhurat, që jep efekt nga 1 janari i vitit tjetër.

Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera programohen në nivelin 44,3 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë janë 8% më shumë ose 3,3 miliardë lekë më shumë se i pritshmi i vitit 2023.

Nga taksat doganore programohen 9 miliardë lekë më shumë, 9 miliardë lekë në total, ndjesë, ose 3% më shumë se i pritshmi për vitin 2023. Nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë para shikuar 156, 7 miliardë lekë, ose 13 miliardë lekë më shumë sesa krahasimi me të pritshmen e vitit 2023. Kjo mbështetet te rritja ekonomike, siç e përmenda, por edhe mbi rritjen e pagave dhe të kontributeve si rezultat i zbatimit të reformës së pagave në administratë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Relatorët?

Zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Pa dashur të përsëris të gjitha elementet që përmendi ministri, do të doja të ndalesha te faktorët kryesorë që ndikuan në performancën pozitive të realizimit të të ardhurave për vitin 2023, të ardhura që kapin shifrën 647 miliardë lekë, si fiskalizimi, lufta ndaj informalitetit, kontrolli i zinxhirit të transaksionit ndërmjet operatorëve, zgjerimi i aktivitetit ekonomik, duke u mbështetur në performancat e mira të sektorit privat, si dhe rritja e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si rezultat i të gjithë reformës të pagës minimale dhe maksimale mbi të cilën llogariten kontributet, reformat në fushën e pagave të sektorit publik që solli rritjen e pagave, rrjedhimisht dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në këtë sektor, reduktimi i informalitetit në fushën e deklarimit të pagave në sektorin privat, si dhe të rritjes së kontributeve për pensionet vullnetare në sektorin e bujqësisë.

Sipas zërave, sa i përket realizimit të pritshëm të të ardhurave, sikundër e përmendi edhe pak më parë ministri, të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë rritur me 32,9 miliardë ose 8%, që përbëjnë 65,5% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Të ardhurat nga fondet speciale janë rritur me 21,6 miliardë ose 18%, që përbëjnë 22,3% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit,. Nga pushteti vendor janë rritur me 0,1 miliard. Këto të ardhura përbëjnë 4,3% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit dhe të ardhurat jotatimore janë rritur me 1,6 miliardë apo 5% dhe përbëjnë 3,2% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Sa u përket të ardhurave të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2024, ndër objektivat kryesorë të projektbuxhetit është rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit duke mundësuar rritjen e mbështetjes buxhetore për sektorët e ndryshëm të ekonomisë, siç janë arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, rritja e pagave dhe e pensioneve, rritja e investimeve në infrastrukturë, në bujqësi, energji e të tjera, mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe reduktimin gradual të borxhit publik.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2024 parashikohen të arrijnë një nivel prej 675 miliardë lekë, duke u rritur me 27,5 miliardë lekë ose 4 pikë për qind krahasimisht me të ardhurat e pritshme të vitit 2023. Këto të ardhura parashikohen te 27,7% e produktit të

brendshëm bruto, nga 27% e produktit të brendshëm bruto të realizuara në vitet 2019-2022. Rritja e të ardhurave parashikohet të vijë, së pari, nga përmirësimi i administrimit fiskal, duke zgjeruar bazën tatimore dhe duke reduktuar evazionin fiskal, përmirësimi i politikave tatimore, rritja reale e produktit bruto, konjuktura e çmimeve ndërkombëtare dhe indeksi i çmimeve të konsumit, zhvillimi i vullshëm i sektorit të turizmit dhe i sektorëve të tjerë të lidhur me të, rritja e volumit të importeve, prodhimit vendas, e konsumit të mallrave të forta si karburanti, cigaret, pijet alkoolike, veçanërisht për shkak të rritjes së numrit të turistëve në vend; vazhdimi i reformës për rritjen e pagave në sektorin publik, i cili do të japë të ardhura shtesë në formën e tatimit mbi pagat, si dhe në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, po ashtu dhe rritja e numrit të punëmarrësve dhe e pagës mesatare në sektorin privat, e cila pritet të ndjekë ritmin e rritjes së pagave në sektorin publik.

Kontributi i politikave fiskale të ndërmarra më parë dhe i politikave të reja të parashikuara në paketën fiskale të 2024-ës dhe efektet respektive të tyre në buxhet parashikohen si më poshtë:

Në lidhje me politikat fiskale, rritja e akcizës së cigareve e miratuar në vitin 2022, sipas kalendarit për periudhën 2022-2026, si dhe vendosja e kufirit maksimal të rritjes së akcizës çdo 2 vjet prej 1,5% në paketën fiskale 2024. Ky efekt do të jetë 0,75.

Rritja e taksës nacionale të regjistrimit të operatorëve dhe tatimit për të ardhurat në fushën e basteve sportive *online*.

Përfshirja në skemën e taksimit nga 1 janari i vitit 2024 i subjekteve që furnizojnë me shërbime profesionale.

Rritja e taksës së karbonit, për qymyret, do të jetë 0,14.

Përfshirje nga TVSH-ja për sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë për importin e gjedhëve të mbarsura, kosheret me bletë dhe importet e insekteve me minus 0,15 dhe në total 5,74.

Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit, sipas grupeve kryesore parashikohet si më poshtë:

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëjnë rreth 66,3% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohen të rriten me 23,2 miliardë lekë apo 5,5%.

Faktorët kryesorë që parashikohet të ndikojnë në rritjen e të ardhurave nga tatimet dhe doganat, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe efektet e tyre në buxhet janë si më poshtë:

Rritja ekonomike me 15 milionë, indeksimi i çmimeve 4, masat e reja fiskale 7 milionë, reformat e pagave 12 milionë lekë, përmirësimi në administrim 7,5 milionë lekë. Në total 45 milionë e 500 mijë lekë.

Të ardhurat nga fondet speciale përbëjnë rreth 23,4% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohen të rriten me 13,3 miliardë lekë apo 9,2%. Të ardhurat nga pushteti vendor përbëjnë 4,3% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 1,4 miliardë lekë apo 4,9%.

Të ardhurat jotatimore përbëjnë rreth 3,6% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 3,2 miliardë lekë apo 15,4%.

Të ardhurat nga ndihmat përbëjnë 2,5% të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të reduktohen me 13,6 miliardë lekë apo 44,5%.

Sa u përket shpenzimeve, ajo që bëhet është, së pari, një lloj vlerësimi për shpenzimet korrente që përbëjnë 78% të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime priten të rriten me 44 miliardë lekë apo 8,8%.

Shpenzimet kapitale përbëjnë 19,6% të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit në krahasim me një vit më parë dhe priten të rriten me 25 miliardë lekë apo 22%.

Parashikimi i shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2024

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2024 parashikohen në nivelin 736 miliardë lekë, duke u rritur me 37,7 miliardë lekë apo 5 pikë përqindje në krahasimisht me realizimin e pritshëm të vitit 2023. Këto shpenzime parashikohet të arrijnë në nivelin 30,2% të produktit të brendshëm bruto, duke qenë në të njëjtin nivel me realizimin e pritshëm të vitit 2023. Planifikimi dhe alokimi i shpenzimeve mbështetet në prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, duke i dhënë përparësi, sikundër e përmendëm edhe në relacionin e mbledhjes që u bë para dite, sektorët kryesorë siç janë digjitalizimi, turizmi, siguria kombëtare, energjia, bujqësia, zhvillimi rural, integrimi europian dhe antikorrupsioni.

Projektbuxheti i vitit 2024 siguron mbështetje për forcimin e mëtejshëm të strukturave negociatore në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Europian në ministritë dhe agjencitë zbatuese.

Rritja e shpenzimeve, sipas grupeve kryesore në krahasim me realizimin e të pritshmit të vitit 2022, parashikohet si më poshtë:

Shpenzimet korrente përbëjnë rreth 82,2% të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohet të rriten me 60,6 miliardë lekë ose 11%.

Shpenzimet kapitale përbëjnë 17,5% të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohen në vlerën 128,5 miliardë lekë, duke u reduktuar me 8 miliardë lekë apo 6%. Shpenzimet kapitale parashikohen në nivelin 5,3% të produktit të brendshëm bruto nga 5,9% e produktit të brendshëm bruto, sipas realizimit të pritshëm për vitin 2023. Në planifikimin dhe detajimin e shpenzimeve kapitale prioritet u është dhënë financimit të projekteve me rëndësi strategjike, si dhe financimit të projekteve në vazhdim.

Sa u përket prioritetëve kryesorë të shpenzimeve buxhetore për vitin 2024, janë, së pari, mbështetja me financim me ushtrim në të gjitha funksionet e qeverisjes qendrore dhe vendore. Sektorët kryesorë që do të mbështeten janë, në radhë të parë sektori i infrastrukturës dhe energjisë. Në këtë sektor do t'i jepet prioritet zgjerimit të mirëmbajtjes së rrjetit të rrugëve kombëtare, zgjerimit të aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe të kanalizimeve, si dhe rritjes së eficiencës së energjisë.

Disa nga projektet kryesorë të transportit rrugor për periudhën afatmesme janë ndërtimi i tunelit të Llogorasë, porti detar i Durrësit “Porto Romano”, hekurudha Tiranë-Rinas dhe linjat Tiranë-Durrës, si dhe zgjerimi i aksit Elbasan-Qafë Thanë.

Sa i përket një tjetër sektori ndër më kryesorët dhe më kontribuuesi në ekonominë shqiptare është sektori i bujqësisë dhe i zhvillimit rural. Në këtë sektor do të mbështeten me prioritet për periudhat afatmesme 2024-2026 garantimi i sigurisë ushqimore, shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe shëndeti i bimëve, konsolidimi i pronësisë në tokën bujqësore dhe administrimi i qëndrueshëm i saj, rritja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore, mbështetja për agro-industrinë, duke zgjeruar kështu zinxhirin, mbështetja për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale, administrimi i sistemit të ujitjes, mbështetja financiare dhe asistencë teknike për fermerët, zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të peshkimit dhe i akuakulturës.

Një tjetër sektor që do të ketë mbështetje dhe është prioritet është sektori i arsimit, që përbën rritjen e numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor, reduktimi i numrit të klasave kolektive, sigurimi i shërbimit të transportit, ofrimi i teksteve shkollore falas, ofrimi i bursave financiare për fëmijët në familjet me nevoja të veçanta, hartimi i programeve specifike për arsimimin e grupeve të pafavorizuara, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, zhvillimi dhe

zbatimi i kurrikulave bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e Bashkimit Europian dhe fuqizimi i teknologjisë së informacionit.

Sektori i shëndetësisë do të vijojë të ketë një mbështetje dhe prioritet për sa i përket financimit të shërbimeve shëndetësore parësore spitalore, qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të situatës financiare të institucioneve shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale, rritjes së kostove të efikasitetit të listës së barnave dhe të pajisjeve të rimbursueshme, financimit të paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike dhe jopublike, pagesave me kujdes shëndetësor, intensifikimit të punës për kostimin e shërbimeve të reja shëndetësore dhe financimit të shërbimit të kontrollit bazë mjekësor.

Sektori i turizmit është një tjetër sektor prioritar. Në këtë sektor rëndësi do të ketë diversifikimi i produktit turistik për të arritur në turizëm gjithëvjetor, sigurimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare, zhvillimi i produkteve të shtëpive të reja, kthimi i trendit pozitiv në pyje, përdorimi i burimeve pyjore në mënyrë të qëndrueshme dhe rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura.

Në lidhje me shpenzimet e tjera, një tjetër prioritet do të jetë rritja e pagave dhe e pensioneve. Shpenzimet e personelit për vitin 2024, reflektojnë koston aktuale të administratës publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave të nisura më 1 prill të vitit 2023.

Në këtë aspekt fondi për vijimin e rritjes së pagave, duke filluar nga data 1 korrik e vitit 2024, është planifikuar në shumën 11 miliardë lekë dhe përfshin rritjen e pagës për punonjësit e sistemit shëndetësor, arsimor, punonjësit me grada dhe punonjësit e administratës publike. Shpenzimet totale për pagat në administratën publike janë planifikuar në masën 119,7 miliardë lekë apo 4,9% të produktit të brendshëm bruto.

Gjithashtu, për vitin 2024 parashikohet një fond prej 4,1 miliardë lekësh për indeksimin e pensioneve dhe 3,6 miliardë lekë për bonusin e fundvitit për pensionistët.

E fundit, mbështetja e shtresave sociale në nevojë, duke parashikuar shpenzimet për pagesën e papunësisë në vlerën 800 milionë lekë, shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe të politikës së fëmijëve parashikohet në vlerën 26,3 miliardë lekë apo 1,1% të produktit të brendshëm bruto, për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1,2 miliardë lekësh, për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2,2 miliardë lekësh apo 0,1% e produktit të brendshëm bruto.

Kolegia tjetër Antoneta Dhima mund të vijojë me pyetjet dhe qëndrimet që ne kemi në lidhje me relacionin që ne të dyja, në cilësinë e relatorëve, kemi përgatitur për komisionin para se t'i kërkojmë komisionit miratimin e të dy elementeve të projektligjit.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Në fakt, zonja Dhima, thotë se zonja Gjylameti ka kaluar te shpenzimet duke i paraprirë madje edhe ministrit. Ministri foli vetëm për të ardhurat, ndërkohë që ju kaluat edhe te shpenzimet.

Blerina Gjylameti – Patjetër, zoti kryetar ka shumë të drejtë.

Ministri gjatë prezantimit të buxhetit foli në mënyrë jo shumë të detajuar për shpenzimet, deficitin, për borxhin publik dhe investimet, kështu që unë vazhdova me relacionin.

Eduard Shalsi – E konsiderojmë diskutimin edhe për shpenzimet të ezauruar.

Zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, kryetar!

Atëherë, meqenëse relatorja numër një e ezauroi edhe pjesën e shpenzimeve unë nuk kam ndonjë gjë për të shtuar. U përmendën të gjithë sektorët dhe mbështetja...

Eduard Shalsi – Zonja Dhima, në sfond dëgjoj zotin Sinaj, apo nuk ka lidhje? Në rregull.

Zonja Dhima, fjala për ju.

Antoneta Dhima – Zoti kryetar, nuk kam gjë për të shtuar. Zonja Gjylameti bëri prezantimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Eduard Shalsi – Zonja Dhima, të iku zëri.

Antoneta Dhima – Zoti kryetar, unë të dëgjoj.

Zonja Gjylameti e përmendi edhe pjesën e shpenzimeve, kështu që nuk kam ndonjë gjë për të shtuar në cilësinë e relatores.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë, a keni pyetje?

Zoti Xhelili? Jo.

Mu duk sikur ngritët dorën.

Zonja Zake? Jo.

Zoti Braçe, fjala për ju, apo as ju nuk keni pyetje?

Ndize pak mikrofonin.

Erion Braçe - Në radhë të parë unë kam një shqetësim, që e kemi diskutuar thuajse çdo vit, që nga viti 2019, kur mori udhë një ndryshim që ka dëmtuar rëndë të gjithë sektorin e grumbullimit dhe të përpunimit të brendshëm të produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshi bulmetin, mishin, perimet dhe çdo gjë tjetër dhe e goditi në momentin kur një industri e re e lehtë ushqimore sapo po hidhte bazat e saj, edhe me ndihmën e të gjithë donatorëve, kryesisht të financimeve të Bashkimit Europian përmes programit IPARD; pra shqetësimi është tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet drejtpërdrejt me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Jam munduar që vazhdimisht ta sjell me një skemë të qartë se çfarë ndodh dhe pse prodhimi vendas diskriminohet në këtë aspekt dhe pse prodhimi i importit, ai që vjen nga importi, favorizohet nga kjo skemë. Është shumë e thjeshtë. TVSH-ja që duhet paguar është TVSH-ja në shitje, minus TVSH-në në blerje. Në momentin që TVSH-ja në blerje nga bujku është zero, pra nuk ka TVSH fare, dhe TVSH-ja në shitje është 20% nga grumbulluesi, përpunuesi e të tjerë me radhë, praktikisht kemi humbur apo kemi dalë nga skema e tatimit mbi vlerën e shtuar. Jemi në një tatim mbi qarkullimin, që, në fakt, nuk ekziston në Shqipëri, pra faktikisht është tatim mbi qarkullimin. Po e bëj më të thjeshtë, në qoftë se unë i blej, meqenëse është në modë dhe është përhapur gjerësisht, 50 lekë kastravecët për t'i bërë gogozhare, për t'i përpunuar apo edhe për t'i shitur në tregun e brendshëm, TVSH-në e kam zero, shtoj aty brenda shpenzimet e mia, plus edhe fitimin, do ta shes me 60 lekë kilogramin. Këtu kam TVSH 20%, që 1/6-ta i bie 10 lekë. Atëherë, sipas skemës së TVSH-së, TVSH në shitje, minus TVSH në blerje, i bie të paguaj 10 lekë dhe nuk fitoj absolutisht asgjë, përkundrazi, humb edhe paratë e mia në këtë aspekt. Pyetja është: pse jam unë i interesuar të marr prodhim vendas? Nuk kam asnjë lloj interesi sa kohë që humb edhe nga lekët e mia, pra jo vetëm nuk fitoj, por humb edhe lekët e mia. Ndërkohë, po ta marr këtë produkt në import, kam 20% TVSH në blerje, kam edhe 20% TVSH në shtije, diferenca midis tyre bën që unë të paktën në këtë rast 50 lekë, në 60 lekë, të fitoj diku te 8,3 lekë. Pra, jo vetëm që nuk humb, por fitoj 8,3 lekë, mbuloj shpenzimet e mia, kam edhe fitimin tim.

Çfarë ka sjellë kjo gjë si pasojë nga viti 2019 e këtej? Informalitet total. Po t'i shohësh sot të gjitha tregjet e Tiranës të produkteve bujqësore dhe blegtorale, edhe ato që janë pranë supermarketeve, por jo brenda tyre, kurrkund nuk kanë faturë të produkteve dhe në momentin që

ti blen, blen pa faturë. Kjo ndodh, pikërisht, për këtë arsye. Por më keq se kaq ndodh te fabrikat e përpunimit, që po t'i shohësh dhe po t'i kontrollosh ato TVSH në blerje e kanë të deklaruar pafund, por jo nga produkti i bujkut, por nga çdo malli tjetër që ata fusin në fabrikën e tyre, në shërbim të prodhimit apo të aktivitetit të tyre: goma, energji elektrike, motorë, makina e gjithçka tjetër. Pse? Për t'i marrë lekë shtetit, jo për t'i dhënë lekë. Në krahun tjetër kemi edhe një rrënim qoftë të cilësisë së produkteve, qoftë edhe të përdorimit të faktorëve të tjerë plotësues, veçanërisht në prodhimin e bulmetit. Pra, janë disa elemente negative që ka sjellë aplikimi i kësaj skeme.

Unë nuk jam në gjendje sot t'ju them si rregullohet, sepse realisht nuk dua që bujku të humbë para, nuk dua që grumbulluesi, përpunuesi të humbin para, por nuk dua as që shteti të humbë para. Në këto tri elemente ajo çka rëndon shumë është informaliteti. Ne na duhet një skemë e tatimit mbi vlerën e shtuar për këtë segment të tregut, grumbullim dhe përpunim brenda vendit, që i bën të gjithë fitues, pra e bën edhe bujkun të fitojë, edhe përpunuesit të fitojnë, edhe grumbulluesit të fitojnë, por edhe shteti të marrë atë që i takon. Në fund fare, konsumatori të marrë një produkt, që është cilësor. Kjo është e para.

Së dyti, nga tabela shoh që në vlerë absolute, patjetër, është ashtu siç thotë ministri, secili nga zërat e të ardhurave tatimore është në rritje, por në raport me GDP-në rritja është fare minimale. Natyrisht, na duhet të bëjmë një kapërcim të madh, nuk mund të rrimë gjithmonë në këtë nivel. Po marr tatimin mbi vlerën e shtuar, që ishte 8,7% e GDP-së në vitin 2021, në vitin 2022 ishte 9% e GDP-së, në vitin 2023 ka rënë në 8,7% dhe për vitin 2024 planifikohet 8,7% përsëri. Mendoj se këtu kemi rezervë. Gjithë ky sektor që ju tregova i merr para qeverisë, nuk i jep para qeverisë, sepse informaliteti në atë sektor dhe mungesa e kontrollit patjetër bëjnë që të ardhurat të jenë të munguara në buxhet. Si mendoni, këta njerëz i mbajnë fabrikat hapur me humbje?! Unë nuk mendoj kështu. Rezultatin kontabël mund ta kenë kështu, por nuk janë me humbje, se një pjesë e tyre me këto para po investojnë edhe në sektorë të tjerë, pra kanë dalë nga sektori i bujqësisë dhe i industrisë së lehtë ushqimore dhe po hyjnë në sektorë të tjerë, siç është ndërtimi. Kështu që, unë mendoj se atje ka para, por informaliteti bën që të humbin të gjithë, veçanërisht bujku dhe shteti.

Në anën tjetër, kemi sektorë, të cilëve pa diskutim duhet t'u vendosim regjim TVSH-je. Sektori i bukurisë, ndjesë për të gjithë, duke filluar nga mbjellja e flokëve, te rregullimi i çdo gjëje tjetër, përfshirë edhe mbjelljen e dhëmbëve për një buzëqeshje hollivudiane e të tjerë me

radhë, kështu do të vazhdojë?! T'ju them të drejtën kur marrim TVSH kudo, natyrisht edhe këtu të paktën duhet të vendosim rregull, që të mos kemi informalitet. Kjo, në gjykimin tim, është themelore.

Unë mendoj se rezervën më të madhe e kemi tek tatimi mbi fitimin dhe tek tatimi mbi të ardhurat personale. Tek tatimi mbi fitimin ne vazhdojmë të mbledhim 1,9%, 2,2%, 2,6%, 2,2%. Ju mendoni se realisht në këtë vend fitohet kaq pak, sa edhe ne duhet të marrim kaq pak?! Unë nuk e besoj këtë! Unë vazhdoj t'i refuzoj ato shifrat që, fjala bie, në sektorin e hidrokarbureve fitohet vetëm 30 lekë në 2 000 lekë, që është çmimi i naftës, refuzoj ta pranoj këtë gjë, ashtu siç vazhdoj të refuzoj që në sektorin e ndërtimit fitohet aq pak lekë sa deklarojnë ndërtuesit. Në të dy sektorët informaliteti është shumë i madh dhe, natyrisht, mashtrimi i operatorëve në to është po kaq.

Ndërkohë, tek të ardhurat personale unë mendoj se rezerva akoma më të mëdha. Ju kam dëgjuar, ministër, që po mundoheni të zgjidhni të gjithë skemën e *Airbnb*, shumë mirë bëni, edhe me këtë duhet të merreni fort sa kohë që është një sektor në rritje dhe që po operon në kushte informaliteti të plotë, që shkatërron konkurrencën e drejtë në treg.

Ne kemi hotelet, që nëndeclarojnë për kapacitetet e tyre, nëndeclarojnë për shfrytëzimin e këtyre kapaciteteve, nëndeclarojnë edhe për çmimin. Këtë si do ta zgjidhim? Sepse është shumë e rëndësishme edhe kjo. Unë nuk mendoj se rikthimi te çmimet e referencës është një zgjidhje, por mendoj se deklarimi real është zgjidhje. Thënë këtë, pa më të voglin diskutim mirëpritet e gjithë sjellja e organeve represive fiskale gjatë këtij viti, thuajse lineare, e butë, pa kontroll fare e ku ta di unë. Kjo kërkon që në krahun tjetër operatorët të jenë të drejtë dhe të ndershëm në raport me fiskun, jo të ushtrojnë presion, dhe, në fund fare, të mashtrojnë dhe të fitojnë tej logjike dhe të mos paguajnë asgjë.

Sërisht në lidhje me këtë, që më shumë e kam pyetje se sa të them atë që mendoj, a do të hyjnë në skemë nga 1 janari profesionet e lira, apo do të ketë shtyrje prapë? Me thënë të drejtën, nuk ka logjikë ajo që ndodh, iu referova dje, iu referova edhe sot paradite një skeme apo një krimi që po destabilizon edhe Parlamentin në logjikën e tyre: çfarë ndodh tek ajo skemë për të kuptuar sa para mungojnë akoma në buxhetin e shtetit? Pronari, furnizuesi me tokë, nuk paguante asgjë: as TVSH, as tatim mbi pasurinë e tij, zero. Tani, furnizuesi me tokë ishte edhe ndërtues, këtu paguante diçka; furnizuesi me tokë ishte edhe aksioner, këtu merrte edhe dividend dhe paguante atë normë dividendi, që ne e kemi vetëm 8%, duke mos bërë asgjë, thjesht dhe

vetëm për shkak të pasurisë së tij; furnizuesi me tokë, që ishte edhe ndërtues, edhe aksioner, ishte edhe ekspert i lirë dhe i faturonte vetes nga kompania ku ishte aksioner edhe para për ekspertizë. Ne po prapë atje e tatonim me një normë tatimi, që është gjithnjë më e ulët sesa norma që paguajnë të gjithë të punësuarit. A do të marrë fund kjo histori? Sepse këto janë paratë që mungojnë në buxhetin e shtetit, këto janë paratë që bëjnë atë kapërcimin e madh për të kapur nivelin e 30%-shit të GDP-së së të ardhurave të grumbulluara. Ne nuk mund t'i lëmë. Në qoftë se ne vazhdojmë të bëjmë sikur i mirëkuptojmë të gjithë, që të marrin të gjithë e të tjerë me radhë dhe ai që humb në fund është shteti dhe pastaj, përmes rishpërndarjes...

Interesi ynë final në këtë histori është interesi publik dhe qytetar. Interesi i të pasurve duhet t'i nënshtrohet ligjit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Braçe!

Para se t'ia jap fjalën ministrit për një koment, ne kemi biseduar edhe bashkë, zoti Ministër, në lidhje me skemën 0/20 dhe unë jam plotësisht dakord me inkursionin që ju së bashku me Ministrinë e Bujqësisë do të kalkuloni çfarë ka ndodhur në treg, që është një skemë që ka ndryshuar, ka qenë 20/20, është bërë 6/20, 0/20, pra për të llogaritur sa më shpejt efektet e kësaj, por dukshëm informacioni dhe arsyetimi i kolegut Braçe, të çojnë në njëlloj sjelljeje nga ana e operatorëve që duket më shumë e detyruar për shkak të skemës sesa dëshirës së tyre për të operuar si të tillë. Gjithsesi, është një skemë që e kemi sjellë në vëmendjen tuaj.

Ndërkohë, zonja Zake, ka kërkuar fjalën.

Enslemvera Zake – Faleminderit, zoti kryetar!

Kisha një pyetje lidhur me pjesën e shpenzimeve. Dihet që skema e sigurimeve shoqërore ose skema e shpenzimeve është një skemë deficitare dhe masa e kontributeve shëndetësore dhe shoqërore që derdhet si nga sektori privat, ashtu edhe nga ai shtetëror është e pamjaftueshme për të mbuluar të gjithë skemën e pensionistëve. Megjithatë, ne jemi këtu për të ndihmuar ata që kanë më tepër nevojë dhe ata që janë kategoria më e brishtë, që janë pensionistët.

Nga parashikimi i shpenzimeve për vitin 2024 thuhet se 4,1 miliardë lekë do të akordohen për indeksimin e pensionistëve dhe 3,6 miliardë lekë janë për bonusin e tyre në fundvitit, që në total vlera shkon 7,8 miliardë lekë. Gjatë vitit 2024 a parashikohet që të ketë një indeksim tjetër të pensioneve për pensionistët, nëpërmjet rialokimit të shpenzimeve të papërdorura gjatë vitit, ose a ka në plan qeveria ose Ministria e Financave të bëjë një

rishpërndarje të indeksimit të pensionistëve gjatë vitit 2024, pasi dimë se norma e inflacionit sa vjen dhe është në rritje?

Kam edhe një pyetje tjetër lidhur me shpenzimet për subvencionet, të cilat janë parashikuar në masën 1,85 miliardë lekë, që krahasuar me buxhetin e vitit 2023 kanë vetëm një rritje të lehtë, kryesisht këto fonde i dedikohen skemës së garancisë rinore dhe bashkëfinancimit me BE-në, ndërsa pjesa tjetër rialokohet tek ato shpenzime, të cilat janë të përvitshme në buxhetet që kemi miratuar, si ujësjellës-kanalizime. A ka Ministria e Financave një plan tjetër subvencioni në kategori apo fusha të tjera të strategjisë së zhvillimit, sepse e dimë që subvencionet përkthehen ndryshe në rritje ekonomike?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ka pyetje nga kolegë të tjerë, para se t'ia kaloj fjalën ministrit? Po, kanë zonja Dhima dhe zoti Sinaj.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin e të ardhurave, se pjesën e shpenzimeve e tha zonja relatores!

Faktorët kryesorë, të cilët do të ndikojnë në performancën pozitive të të ardhurave, janë pjesa e fiskalizimit, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve. Kemi disa vite që flasim për luftën ndaj informalitetit. Do të doja të dija: cilat janë instrumentet që do të përdorni për të siguruar të ardhura ndaj luftës kundër informalitetit?

E dyta, të ardhurat nga pushteti vendor do të rriten rreth 4,3% dhe parashikohet të jenë gati 1,4 miliardë lekë ose 4,3%. Ku konsiston kjo rritje e të ardhurave të pushtetit vendor? Si do të sigurohen këto të ardhura nga pushteti vendor? Cilët janë zërat kryesorë që do të sjellin këtë rritje të të ardhurave për pushtetin vendor?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Sinaj, fjala për ju.

Hapeni mikrofonin, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj - E gjeta më në fund mikrofonin.

Atëherë, po të diskutojmë për buxhetin, të gjithë do të kemi nga një pretendim dhe të gjithë mund të japin nga një mendim. Mendoj se qeveria dhe ministri i Financave e kanë parë ekuilibrin e investimeve, e kanë parë në tërësi ekuilibrin e ekonomisë shqiptare, por unë kisha një shqetësim të vogël. Dëgjoj që diskutohet shumë për biznesin, për tatimin, për rritjen e taksave

dhe për mundësinë e pagesës së taksave. Jam dakord që nuk duhet të ketë fshehje të pagesës për taksat, por do të thosha se janë ato biznese dhe janë ata investitorë të cilët punojnë përditë për ta plotësuar këtë buxhet, që ne të kënaqim kërkesat dhe interesat e shqiptarëve, duke bërë rritje pagash apo indeksim pensionesh. Pra, të gjitha këto vijnë nga puna e atyre njerëzve që me ide, me përkushtim, punojnë jo vetëm për vete, por edhe për të gjithë shoqërinë, ndaj do të doja të kishim më shumë respekt kur flasim për investitorët dhe për biznesmenët.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Shoh që zoti Braçe ka ngritur dorën.

Erion Braçe – Zoti Kryetar, është e disata herë që bëhet kjo lloj ndërhyrje dhe ky lloj dialogu. Të them të drejtën, tingëllon edhe keq. Unë nuk doja t'i hyja kësaj historie, por, nëse flasim për kontribute të tjera si puna e këtyre, në buxhetin e shtetit (besoj se më korrigjon ministri) kontributit i drejtpërdrejtë nga këta sipërmarrës, biznesmenë, oligarkë e të tjerë me radhë, është vetëm 2,2% e GDP-së. Në qoftë se këtu fusni TVSH-në, atë nuk e paguan biznesmeni, as oligarku. TVSH-në e paguan konsumatori, ne të gjithë që jemi këtu. TVSH-ja ishte 8 pikë ca përqind. Në qoftë se do të fusni edhe akcizat, të cilat janë rreth 2,5% të tjera, edhe ato i paguan qytetari, sepse në fund të fundit është taksë konsumi, nuk ka lidhje me shpirtin që po i marrim biznesmenit e të tjera. Nëse do të fusni pastaj edhe taksat kombëtare, taksat nacionale, edhe këto i paguajmë ne, i paguan qytetari, nuk i paguan biznesmeni. Pra, do të ishte mirë që herë tjetër të mos e vazhdojmë këtë lloj dialogu, sepse po e vazhduam atë, do të kalojmë edhe në vlerë absolute pastaj dhe diferenca midis asaj që paguan qytetari dhe asaj që paguan (në fakt që fiton, sepse nuk paguan) biznesmeni apo sipërmarrësi është shumë e thellë. Unë kam përshtypjen se fola qartësisht dhe me numra dhe kur them që ka rezerva, është e vërtetë që ka rezerva. Tani, a ka ndonjë që të më thotë se gjatë kësaj vere i gjithë sektori i hotelarisë, i restoranteve, nuk ka bërë namin, në një kohë kur paratë nuk janë në buxhetin e shtetit, për të reflektuar namin e bërë? A ka njeri të më thotë se sektori i ndërtimit është me humbje? Nëse ka njeri, të ma thotë! A ka njeri të më thotë që sektori i ndërtimit deklaron realisht vlerën e njësisë që shet? Nuk ka! Le të dalë njeri të më thotë që është biznesmen ndërtimi dhe deklaron qindarkë më qindarkë 3 mijë euro për metër katror në shitje! A ka njeri të më thotë që beson realisht se sektori i hidrokarbureve fiton vetëm 30 lekë në 2 mijë lekë që është litri i naftës? Unë nuk besoj që ka njeri. Nëse doni t'i pranoni këto gjëra, jam dakord, nuk ka asnjë lloj problemi, por vetëm për budallenj nuk na merr dot njeri. Është shumë e thjeshtë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Sinaj e ka kërkuar përsëri fjalën.

Vullnet Sinaj – Unë nuk dua të mbroj askënd. Këtu është çështje koncepti, se si e koncepton secili nga ne, investitorët e këtij buxheti. Unë do të thosha se TVSH-ja që vjen në buxhetin e shtetit është e antishpuar nga biznesmenët, nga kapitalet e tyre, sepse paguhet qysh në doganë. Kur vjen malli në doganë, TVSH-ja parapaguhet. Është puna e kujdesshme e njerëzve që bëjnë biznes, për të cilët edhe një herë do të kërkoja më shumë respekt, dhe e kompanive që kontribuojnë në këtë biznes.

Unë them se është shumë e thjeshtë të bësh buxhet. Kur jam futur për herë të parë në politikë, kam parë se për buxhetin ishte gjithë ai diskutim se si t'i raciononim apo t'i ndanim të ardhurat e tij për të gjithë shoqërinë, për shëndetësinë, për arsimin, për policinë, dhe m' u duk gjëja më e thjeshtë, sepse kisha provuar në shpatulla, siç e provojnë të gjithë biznesmenët në shpatullat e tyre se si t'i realizojnë këto të ardhura, se si t'i mbajnë të gjithë ata punonjës, se si ta paguajnë TVSH-në përpara kohe, se si të paguajnë tatim fitimin, se si të paguajnë dividendin, dhe në fund se si të sigurojnë që kompania të vazhdojë. Unë nuk kam gjë me asnjë, por për hatër të asaj nga vij dhe për bindjet e mia, ekonomia e tregut dhe biznesmenët të cilët janë në krye të kësaj ekonomie tregu janë baza e saj, janë njerëzit që me punën e tyre të palodhur e bëjnë të mundur buxhetin e këtij vendi.

Jo vetëm ata, në fakt, sepse është edhe vizioni i qeverisë, nuk do ta mohojmë kurrë vizionin e Kryeministrit dhe të qeverisë, sidomos në lidhje me turizmin, absolutisht jo, pasi është një vizion shumë i qartë, për të cilin sot mund të themi me mijëra gjëra. Ky vizion fillon qysh nga pastrimi i plazheve, nga heqja e mbeturinave në qytet, nga këmbëngulja gjatë të gjitha këtyre viteve për t'u thënë që rregullimi i ambienteve të jashtme është sa për fasadë. Të gjitha këto dhanë rezultatin që buxheti i vitit 2024 të jetë më shumë se dyfishi i vitit 2012.

Nga ana tjetër, edhe ata biznesmenë, kolegët e mi që vazhdojnë të bëjnë biznes, kanë dhënë kontributin e tyre, sepse është e vërtetë që TVSH-në në fund e paguan konsumatori, por janë ata që e trajtojnë gjatë të gjithë kohës këtë TVSH, e japin më përpara në doganë, pastaj e kalojnë nëpërmjet faturave. Unë nuk dua të mbroj ndonjë biznesmen të pandershëm, që mundohet të fshehë të ardhurat. Për ata biznesmenë, bie 100% dakord me kolegun që kontrolli tatimor duhet të forcohet, pasi jo vetëm do të rrisë buxhetin, por do t'i vendosë edhe biznesmenët në një rang të barabartë përpara kërkesave të ligjit dhe të shtetit. Nëse nuk do të ketë barazi në

grumbullimin e taksave, do të ketë pabarazi dhe një konkurrencë të pandershme në treg, kështu që do të isha dakord për këtë. Nga ana tjetër, asnjëherë nuk tërhiqem nga mendimi im, sepse jemi në kapitalizëm dhe në ekonomi tregu, ku vlerësohet puna e njerëzve me ide. Janë ata që e çojnë përpara shoqërinë, por që rrisin edhe ekonominë e vendit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Braçe e ka ngritur përsëri dorën.

Erion Braçe – Unë nuk e dija se në këtë vend janë ngritur sipërmarrje dhe ka biznesmenë të cilët rrojnë për t'i paguar shtetit TVSH-në. Unë dija që këta merren me sipërmarrje për të fituar para dhe natyrisht fitimi i tyre është baza e aktivitetit të tyre. Kështu që, logjika se këta na bëjnë nder të madh, pasi i mbajnë bizneset e tyre për të paguar TVSH-në të cilën e paguajmë ne, sepse këta thjesht bëjnë agjentin e qeverisë, sigurisht pa pagesë, por thjesht bëjnë agjentin e qeverisë, nuk më shkon. Mbi të gjitha, po shkoj në invers: çdo lek TVSH-je i munguar në buxhetin e shtetit nga ajo që ata mbledhin nga qytetarët konsiderohet evazion fiskal, siç thuhet, por që në fakt është grabitje, për të qenë të qartë. E thashë edhe një herë që, nëse ka qoftë edhe një tatim në këtë tabelën e të ardhurave të buxhetit, që impakton drejtpërdrejt sipërmarrësit, ai është tatimi mbi fitimin. Asgjë tjetër nuk e impakton sipërmarrësin nga e gjithë kjo lista e gjatë e tatimeve dhe e taksave. Përkundrazi, këto të gjitha impaktojnë qytetarin. Kur ne themi që TVSH-ja të jetë zero për këtë apo për atë, e themi që të çlirojmë qytetarin, jo për të çliruar biznesmenin. Të them të drejtën, po të jetë për biznesmenin, unë mendoj se çdo sipërmarrje i ka aq para sa t'i dalin edhe të fitojë, edhe të paguajë detyrimet ndaj shtetit.

Faleminderit!

Vullnet Sinaj – Një sekondë, kam vetëm një gjë të vogël, zoti Kryetar!

(Mungesë incizimi)

Eduard Shalsi – Dëgjohem apo jo?

Atëherë, zoti Sinaj, ju lutem, keni fjalën shumë shkurt! Të përgatiten zonja Resulaj dhe zoti ministër.

Vullnet Sinaj – Atëherë, dua të them vetëm një gjë. Nuk mund ta minimizojmë kontributin e biznesit tek tatimet e dividendit apo tek tatimet e të ardhurave. Sa punonjës janë në Shqipëri? Janë 700 mijë? Në shtet janë 80 mijë punonjës, pra 600 e ca mijë janë në sektorin privat, në të cilin punojnë, marrin pagat, paguajnë kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Si mund ta minimizojmë këtë gjë?!

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, jo zoti Braçe, sepse kjo do të vijojë *non stop*. Atëherë, me shpejtësi! Zonja Resulaj, bëhuni gati!

Erion Braçe – Zoti Shalsi, kjo puna që biznesmenët po mbajnë me lekë punëtorin është si kënga tallava, të cilën na i përplasim të gjithëve në fytyrë : “Nga taksat e mia paguhesh.”. Është fiks kështu! Del aty poshtë dhe të thonë: “M’ u përgjigj pak, se nga taksat e mia paguhesh!”. Edhe historinë që biznesmeni mban me rrogë punëtorin, i cili bën të mundur që sipërmarrja të rrijë në këmbë, që sipërmarrja të prodhojë dhe të fitojë para, nuk di si ta quaj! Nejse, kemi kohë për t’i diskutuar të gjitha.

Eduard Shalsi – Atëherë, fjalën e ka zonja Resulaj dhe të bëhet gati zoti ministër.

Pranvera Resulaj – Faleminderit!

Në fakt, dua të flas shumë shkurt, sepse gjithçka vërtitet rreth mbledhjes së të ardhurave. Edhe unë po pyes lidhur me përqindjen ndaj GDP-së. Pse vendet e tjera të rajonit mbledhin më shumë? Për shembull, po i referohem Serbisë, ku besoj se është rreth 40%, ndërsa ne jemi të kënaqur me 26%. Ndoshta kjo mund t’i japë kuptim dhe mund t’u përgjigjet edhe shumë pyetjeve që u ngritën dhe u diskutuan. Nuk po komentoj më tej, thjesht këtu po ndalem vetëm me një pyetje, e cila ndoshta është edhe retorike.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Resulaj!

Zoti Ministër, në fakt, ju bëtë prezantimin e të ardhurave, ndërkohë që gjatë prezantimit të buxhetit folët pak edhe për shpenzimet. Tani e keni fjalën për të bërë edhe një rezymë të shpejtë të shpenzimeve, për t’u dhënë përgjigje pyetjeve apo për të bërë komente për shqetësimet që deputetët ngritën.

Ervin Mete – Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit edhe zonjës Gjylameti për relatimin e detajuar!

Unë po bëj vetëm disa parashtrës lidhur me shpenzimet, duke theksuar shkurtimisht disa elemente kryesore dhe pastaj do të kaloj te pyetjet.

Siç e përmenda, shpenzimet shkojnë në 735 miliardë, 30,2% e prodhimit të brendshëm bruto, me një rritje 30,4 miliardë më shumë se plani i përditësuar i vitit 2023, një buxhet që për herë të parë e kalon shumën 7 miliardë euro, siç edhe e kemi përmendur. Reforma e pagave është kyçe dhe këtu do të përmend një shifër që besoj se ia vlen për t’u theksuar. Sa u përket

shpenzimeve totale të personelit për vitin e ardhshëm, ato arrijnë në 119,7 miliardë lekë ose rreth 1,1 apo diçka më tepër miliardë euro. Pra, vitin tjetër shpenzimet totale të personelit kapërcejnë vlerën 1,1 miliardë euro dhe këtu një kontribut të ndjeshëm ka rritja e pagave.

Njëkohësisht, investimet publike mbahen mbi 5,3% të prodhimit të brendshëm bruto, ku niveli 5% konsiderohet një nivel i shëndetshëm, dhe adresohen një sërë projektsh, të cilat i kemi përmendur.

Në të njëjtën kohë, sektori i arsimit pëson një rritje të ndjeshme qoftë me komponentin që i alokohet Ministrisë së Arsimit, qoftë me komponentin që alokohet në njësi të tjera shpenzuese. Totali i financimit për arsimin shkon në 78,8 miliardë lekë, pra afro 79 miliardë lekë, dhe kapërcen 12% të shpenzimeve të totalit të buxhetit, për herë të parë në raport përqindjeje dhe në raport me GDP-në qëndron te vlera 3,3%.

Po ashtu, sektori i shëndetësisë pjesën më të madhe të rritjes e merr për shkak të rritjes së pagave, por edhe të një mbështetjeje për paketat e miratuara të shërbimit spitalor dhe për infrastrukturën në shërbime spitalore.

Në sektorin e drejtësisë, të cilin e theksova dhe u elaborua gjatë te Komisioni i Ligjeve, problem theksohet se qysh nga viti 2016 është dyfishuar buxheti për këtë sektor, duke shkuar nga 13,5 në 26,2 miliardë lekë dhe parashikohet që nga viti në vit, pra nga viti 2023 në vitin 2024, të rritet me 4,2 miliardë lekë.

Sektori i mbrojtjes, po ashtu, për herë të parë arrin nivelin 2% të prodhimit të brendshëm bruto, financohet me 48,3 miliardë lekë për vitin e ardhshëm, me një rritje të ndjeshme prej 8 miliardë lekësh nga viti 2023.

Sa u përket disa zërave kyç të shpenzimeve të tjera korrente, kemi transfertën për institucionet e arsimit të lartë për të mbështetur rreth 67 mijë studentë të ciklit të parë të studimeve dhe 26 mijë të ciklit të dytë, duke përfshirë këtu edhe rreth 18 mijë studentë që përfitojnë bursa ekselence, në një total prej 11,5 miliardë lekësh. Për shpenzimet operationale të forcave të mbrojtjes 8,7 miliardë lekë, për mirëmbajtjen e infrastrukturës digjitale 5,9 miliardë lekë. 3,4 miliardë lekë alokohen për skemat e ndryshme të granteve për fermerët, me financim direkt nga buxheti i shtetit; 4,1 miliardë lekë për shpenzimet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së policisë; për strehimin social parashikohen 745 milionë lekë. Ndërkohë parashikohen rreth 2 mijë kredi me norma të lehtësuara për kategori të përcaktuara punonjësish.

Gjithashtu, siç e kemi theksuar, është kompensimi për ish-pronarët dhe për kategori të tjera në mbrojtjen sociale, që në tërësinë e tyre e kalojnë një të tretën e buxhetit. Po ashtu, pushteti vendor merr një mbështetje të ndjeshme. Këtu do të përmend vetëm një shifër, që transferta e pakushtëzuar për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, është 12 % më e lartë, ndërsa krahasuar me vitin 2015, viti kur është bërë Reforma Administrative Territoriale, është 92 % më e lartë. Praktikisht, kjo do të thotë se ka pothuajse një dyfishim të transfertës, dhe vitin tjetër totali i transfertës për buxhetin vendor shkon 36,5 miliardë.

Kalojmë tani tek pyetjet, të cilat po përpiqem t'i marr me radhë. Sa i përket TVSH-së në bujqësi, është fjala për një diskutim që e kemi bërë me vite, por njëkohësisht është diskutim edhe i një sërë vendesh të tjera. I referohet një elementi strukturor, sa i përket produktit bujqësor, i cili është një produkt, i cili edhe pse ka kosto që i vijnë me TVSH, do të duhet të futet në zinxhirin e TVSH-së si një produkt nga jashtë zinxhirit, po themi. Në lidhje me këtë ka një sërë versionesh, dhe diskutohet gjatë mekanizmi se si kjo TVSH e mbartur në produktin bujqësor, të mos i ngelet fermerit, sepse në parim TVSH-ja, siç u përmend, duhet të jetë një taksë, e cila nuk i ngelet kosto prodhuesit apo biznesit, por transmetohet te konsumatori. Ky është thelbi i të gjitha përpjekjeve që bëhen edhe në Europë në lidhje me skemat e TVSH-së së fermerit. Ka disa lloj ndërhyrjesh, tre nga të cilat janë më kryesoret. Njëra është TVSH-ja e reduktuar, që ne zbatojmë. Një version tjetër është TVSH-ja e imputeve, që ne kemi tentuar ta zbatojmë. Është edhe një version tjetër të zbatuar në vendet nordike, që i fusin dhe fermerët në TVSH, por kjo ka të bëjë edhe me masën e fermave dhe të prodhimit bujqësor.

Jam dakord me ju, dhe e kemi diskutuar faktin se skema që kemi do të kërkojë një analizë të efektshmërisë. Nga ana tjetër, theksoj se ka qenë një skemë e cila ka ndryshuar gjatë viteve, duke qenë gjithmonë pjesë e diskutimit, por është shumë e rëndësishme që ne të kemi format, i cili arrin efektshmëri së pari e mbi të gjitha në lehtësimin apo eliminimin e TVSH-së së produktit të fermës, e së dyti edhe në një drejtësi fiskale sa i përket eliminimit të informalitetit dhe pabarazive, që përmendi edhe zoti Braçe.

Jemi në diskutim me Ministrinë e Bujqësisë. Unë vlerësoj se duhet mbajtur një diskutim i hapur edhe me komisionin. Besoj se të gjithë kemi vullnetin për t'i dhënë zgjidhjen më të mirë të mundshme. Edhe në lidhje me të ardhurat kemi një strategji afatmesme me Fondin Monetar Ndërkombëtar, duke rënë dakord që ta rishikojmë. Unë besoj se një nga pikat që duhet

parashikuar edhe strategjikisht në afat të mesëm është pikërisht analizimi dhe rishikimi i qasjes sa i përket TVSH-së fermerit. Kjo strategji...

Eduard Shalsi – Zoti Ministër, ndjesë që po ju ndërpres pak!

Kjo taksë, për të cilën të paktën ne, një grup deputetësh, jemi të bindur në nxitjen që po u bën grumbulluesve dhe për faktin se po i shtyn drejt informalitetit. Sa më shpejt të fillojë analiza, sa më shpejt të arrijmë në një vendimmarrje drejt një skeme më efektive e më efektive, aq më mirë do të jetë.

Ervin Mete – Patjetër!

Eduard Shalsi – U bënë disa vite që e kemi shqetësim, por nga ana tjetër nuk kemi parë diku gjetkë ndonjë aplikim të një skeme të tillë. Kësisoj, i vetmi merak është fakti që kemi konsumuar goxha kohë, ndaj do të duhet një përgjigje, por natyrisht edhe Ministria e Bujqësisë duhet të angazhohet hapur. Pra, e kemi tek afati kohor. Këtë doja të sillja në vëmendjen tuaj.

Ervin Mete – Faleminderit!

Patjetër! Do të bëjmë një analizë, bazuar edhe në shifra, duke marrë edhe shifrat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nga Bujqësia, kartat e fermerit, të cilat kanë ndihmuar në formalizim, e kështu me radhë.

Unë besoj se përtej kësaj, do të duhet një qasje sa i përket masave mbështetëse që përmenda, kombinuar pastaj me masat fiskale në bujqësi. Strategjia afatmesme e të ardhurave, e cila siç thashë, ka nevojë të rishikohet së bashku me FMN-në, sepse, meqë po flasim për TVSH-në, aty kanë qenë një sërë taksash apo një sërë ndërhyrjesh të TVSH-ja, që ne nuk mendojmë se në këtë moment janë adekuate. Kësisoj, do ta rishikojmë strategjinë duke pasur fokusin te informaliteti, duke qenë se u bë një pyetje edhe në lidhje me masat që merren për të adresuar informalitetin. Ka plot masa që mund të merren për të adresuar informalitetin, por ju informoj se vetë FMN-ja po bën një qasje rajonale, sepse ne jemi një rajon me problematika të ngjashme. Ndër ato që do të theksoja është data processing dhe data analysis, domethënë analizimi dhe kryqëzimi i të dhënave, ku megjithëse ne kemi sisteme që prodhojnë të dhëna, si sistemi i tatimeve, sistemi i doganës apo sistemi fiskalizimi, mendojmë se ka një hapësirë më të mirë për të kryqëzuar këto të dhëna, për të na çuar pastaj në efekte më të mira të mbledhjes së të ardhurave.

Gjithashtu, sa i përket turizmit, mbledhja e të dhënave mbetet përsëri kyçe. Nga platformat e mëdha, siç është Booking apo Airbnb, që lidhen me turizmin, në momentin që

administrohen të dhënat mund të adresohet edhe mbledhja e të ardhurave. Ka eksperiencën të mirë në këtë drejtim. Gjithë Bashkimi Europian ka arritur t'i marrë këto të dhëna, edhe vende që janë afër nesh. Ne po punojmë që të mund të adresohet mbledhja e të dhënave, që pastaj të mund të përkthehet në mbledhje më efektive të të ardhurave. Kemi një avancim sa i përket Booking në këtë drejtim, e këtu po kaloj në një nga pyetjet e zotit Braçe, sepse Booking do të hapë një përfaqësi në Shqipëri. U ka kërkuar entiteteve që të raportojnë nëse janë të regjistruara në TVSH apo jo. Nëse nuk janë të regjistruara në TVSH, atëherë do të duhet që kjo përfaqësi të mund të mbajë për ta TVSH-në e komisionit, që aplikon platforma për listimin. Gjëja e rëndësishme nuk është vetëm TVSH-ja e komisionit, por niveli i raportimit, që përmendi zoti Braçe, sepse duke e ditur komisioni që aplikohet për tarifën, ne mund të dimë tarifën e aplikuar apo çmimin e dhomave. Siç ju thashë, përpunimi i të dhënave dhe marrja e sa më shumë të dhënave adreson drejtpërdrejt edhe çështje të nënraportimit.

Sa u përket luhatjeve në zëra të veçantë tatimit, veçanërisht të TVSH-ja. Duhet mbajtur parasysh fakti se ne kemi kaluar dy vite me inflacion të lartë, të pazakontë, gjë që është reflektuar edhe në të ardhura, pra të TVSH-ja. Po ashtu kemi pasur çmime të larta të karburanteve, të cilat janë reflektuar të TVSH-ja; kemi pasur importe me çmime tejet të larta të energjisë, e cila reflektohet të TVSH-ja në doganë. Pra, janë trende disi të pazakonta, të cilat mund të kenë rezultuar në një vit të caktuar, por pastaj, në njëfarë mënyre janë amortizuar në raport edhe me GDP-në, sepse inflacioni ka ardhur në ulje.

Tani po kaloj te pyetjet e zonjës Zake. Pra, inflacioni nuk është në rritje, por në ulje. Ne kemi buxhetuar një indeksim për vitin tjetër, në lidhje me pjesën nga tetori në dhjetor, që është rreth 4 miliardë. Sigurisht, ky është vetëm projektion, sepse indeksimi bëhet në bazë të indeksit të çmimeve, që raportohet nga INSTAT-i. Pritshmëria e Bankës së Shqipërisë, pritshmëria jonë është që inflacioni do të vijë në target brenda vitit tjetër. FMN-ja e pret në fillim të 2025-ës, por të dy institucionet jemi disi më optimistë për uljen e inflacionit brenda vitit tjetër. Pastaj, në varësi të faktit se si do të rezultojë indeksi i çmimeve, do të përkthehet edhe në indeksim. Megjithatë, theksoj se tashmë është bërë praktikë që buxhetohet edhe bonusi. Këtë vit, pra gjatë vitit 2023 do të kemi dy bonuse të dhëna për pensionistët: atë që është dhënë në prill, dhe në mos gaboj, do të ketë edhe një bonus tjetër në fund të vitit.

Sa u përket të ardhurave personale dhe të vetëpunësuarit, ligji tashmë i miratuar "Për tatimin e të ardhurave" e adreson këtë çështje. Ligji që ju keni miratuar hyn në fuqi në fund të

janarit, dhe parashikon që të vetëpunësuarit që ofrojnë shërbime profesionale do të përfshihen në tatim, i cili në varësi të marzhit të fitimit nën 14 milionë apo mbi 14 milionë, do të jetë 13 % apo 23 %, e jo vetëm do të taksojë, por do të adresojë dizincitivën për të qenë të punësuar. Sepse tashmë, të vetëpunësuarit dhe të punësuarit, pak a shumë vijnë në të njëjtin marzh efektiv tatimi. Sipas kodeve të nomenklaturës së INSTAT-it, pritet që mbi 30 mijë të vetëpunësuar të preken nga hyrja në fuqi e ligjit vitin tjetër. Në fakt, një pjesë e tyre mund të jenë shtuar edhe për shkak të sistemit lehtësues që ishte për të vetëpunësuarit. Unë gjykoj se tashmë sistemi vendos drejtësi, sa i përket trajtimit fiskal të punës, qoftë në sensin e të vetëpunësuarve, qoftë të punësuarve, të cilët në fund bëjnë një punë, ndaj forma se si regjistrohen nuk duhet të jetë shkak për një diferencim kaq të theksuar të tatimit.

Një tjetër pyetje ishte në lidhje me të ardhurat e pushtetit vendor. Dy janë elementet kryesore që ndikojnë: 1- taksa e pritshme për infrastrukturën; 2- taksat që lidhen me turizmin, pra e fjetjes, pra që mbledh pushteti vendor. Po ashtu, ka edhe një faktor tjetër: na ka rezultuar se pushteti vendor ka nënperformuar sa u përket të ardhurave të këtij viti. Mund të ketë pasur një sërë faktorësh, por besojmë se vitin tjetër do mund të rikuperohen edhe këto të ardhura të pambledhura të këtij viti.

Ndjesë në qoftë se kam harruar ndonjë pyetje. Nëse më lejohet, do të doja të bëja një koment në lidhje me atë që tha zoti Sinaj. Në perspektivën e qeverisë, ne e konsiderojmë partner biznesin. Ne jemi jashtëzakonisht të interesuar për një klimë sa më të mirë të biznesit. Filozofia jonë është, që deri diku ne jemi aksionerë me përqindjen tonë të taksës në çdo biznes. Sa më aksionerë të mirë të jemi ne, aq më mirë performon biznesi, aq më shumë rriten aksionet dhe vlerat tona në shoqëri.

Shumë faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, Ministër!

Ka ndonjë koleg tjetër që do fjalën?

Nëse nuk ka, unë kam vetëm një merak tek të ardhurat personale, zoti Ministër, dhe më duhet ta them, në lidhje me një kategori që e kemi konsideruar prioritet, e cila ka të bëjë me kompanitë e zhvillimit të *software*-ve apo kompanitë e IT-së. Dukshëm në Shqipëri vitet e fundit, falë edhe politikave lehtësuese, do të thosha, tatim-fitimin për to u bë nga 15 në 5, ndërkohë që brenda dy vjetëve të ardhshëm do t'u ngrihet përsëri në 15. Besoj se ky ka qenë një stimul i mjaftueshëm për kompanitë.

Nga ana tjetër, ka një shqetësim, ka edhe një fakt: është një kategori, e cila lehtësisht sot, në kohën e një globalizmi, mund të regjistrohet, të punojë kudo. Unë punoj në distancë, ndaj jua kam transmetuar, kemi bërë edhe një dëgjësë, dhe do të doja që pas kalkulimeve të fundit që do të bëni, në vendimmarrje të shikoni që t'i mos e gruponi si disa grupe të tjera sipërmarrësish apo personash fizikë, pasi kanë veçantinë e tyre dhe në kuadrin e asaj çfarë ofrojnë vendet fqinje, dhe jo vetëm, duhet parë jo çfarë humbasin nga të ardhurat e tyre apo përqindja e të ardhurave që do të paguajnë për shtetin. Jemi absolutisht për një treg, ku të trajtohet gjithkush si i barabartë, por specifikat janë të tilla që duhet parë pak edhe çfarë opsionesh kanë, nëse nuk do të mund të punojnë apo të funksionojnë si persona fizikë në Shqipëri.

Zoti Braçe e ka ngritur dorën.

Fjala për zotin Braçe.

Erion Braçe – Para se të them atë që mendoj për shpenzimet, do të më duhet të bëjë një sqarim fare të shkurtër për TVSH-në e bujqësisë. Skema ka dështuar, sepse gjithmonë është menduar jo si skemë TVSH-je, por si skemë e subvencionimit të fermerit. Kur ne erdhëm në pushtet në vitin 2013, e gjetëm 6 me 20 (6% në blerje dhe 20% në shitje). Na u desh kohë ta kuptonim që ta ndryshonim e ta bënim 20 me 20, por gabimi i madh ishte që iu tha grumbulluesit: “Do të paguash 20% subvencion për fermerë”. Ky ishte gabimi. Duke besuar pafund te kjo sipërmarrje e lirë, e drejtë, e ndershme, e barabartë në këtë vend, ndodhi që edhe fermerët nuk morën 20% të subvencionit që ne e kishim bërë pjesë të kësaj skeme, edhe grumbulluesit u pasuruan pa hesap, në deformim të plotë të asaj që duhej të ishte një skemë TVSH-je. Tani, çfarë kërkoj unë, ashtu siç edhe ata atje poshtë kërkojnë, është të ndahet shumë qartë, pra skema e subvencionit apo e mbështetjes buxhetore duhet të jetë më vete për fermerin dhe duhet të jetë ajo për të cilën kemi folur: lekë për prodhim dhe për cilësi prodhimi, kurse skema e TVSH-së duhet të kthehet në ligjshmëri për të qenë realisht një skemë TVSH-je, se kështu siç është, 0 me 20, është skemë për tatimin e qarkullimit praktikisht. Unë paguaj 20% TVSH në shitje dhe vetëm këtë kam, praktikisht i bie të paguaj tatim për qarkullimin, ndërkohë që në këtë vend nuk ka tatim mbi qarkullimin. Këtë desha të sqaroja, për ta kuptuar. Duhet një ndarje e qartë: çfarë është mbështetja për fermerin duhet të jetë më vete, e palidhur me sipërmarrësit, grumbullues apo përpunues, fare zero, nuk duhet të bëhet më gabimi që është bërë nga viti 2013 deri në vitin 2019.

Ndërkohë, duhet rregulluar skema e TVSH-së që të jetë skemë funksionale TVSH-je, që edhe konsumatori të paguajë atë që i takon, edhe sipërmarrësi të paguajë para, edhe shteti të marrë atë që i takon.

Ndërkohë që për shpenzimet, mendoj se planifikimi që kemi bërë në buxhet është në rregull, me përjashtim të një sektori që e thashë edhe paradite që është sektori i bujqësisë, sepse e rrëzoi skemën që ne planifikojmë tani në buxhetin e vitit 2024 nisur nga fillestari i vitit 2023, i cili është rrëzuar me akt normativ. Mendoj që nuk duhet të planifikojmë nënfinancim nga fakti i vitit 2023. Kjo është rezerva që kam.

Në anën tjetër, ku ka shumë para?! Realisht, ka shumë para. Ai që kam si shqetësim ka të bëjë me raportin midis shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale, sepse kemi të njëjtin raport pothuajse për 30 vjet, ose më mirë të themi nga vitit 2008, kur doli e famshmjia rruga Rrëshen – Kalimash, e këtij kemi të njëjtin raport 5% të GDP-së për investime kapitale, pastaj pjesa tjetër shkon për shpenzime korrente. Mendoj që duhet të tentojmë ta thyejmë këtë raport në favor të shpenzimeve kapitale. Mendoj se ekonomia tani ka nevojë për investime, madje për investime publike, nëse për vitin e ardhshëm e kemi mbështetur shumë fort rritjen ekonomike të shërbimit, tek turizmi, ta themi më qartë fare, më hapur fare. Ky vit tregoi që ne duhet të investojmë shumë më tepër në infrastrukturë; duhet të investojmë shumë më tepër në energji elektrike; duhet të investojmë shumë më tepër në furnizimin me ujë; duhet të investojmë shumë më tepër në kanalizimin e ujërave të zeza; duhet të investojmë shumë më tepër në pastrim. Kemi nevojë të investojmë që t'i përmirësojmë shërbimet. Nëse ky vit na tregoi që të gjithë të huajt thoshin: “Ku është stacioni i autobusit? Si shkohet nga aeroporti në Sarandë, në Dhërmi, në Himarë, në Theth, në Tropojë?” e kështu me radhë, na duhet që të investojmë në transport, jo vetëm në rrugë, po edhe në ndërtimin e këtij shërbimi. Sot që flasim, kemi një shërbim mizerabël urban, jo vetëm brenda qyteteve, por edhe ndërrurban, nga Tirana në drejtim të të gjitha këtyre qyteteve. Po investohet në hekurudhë, shumë mirë bëhet, pa më të voglin diskutim, por na duhet një plan se si ne e ndihmojmë turizmin duke zgjidhur problematika që i bezdisin njerëzit, ua bëjnë të lodhshme ardhjen në Shqipëri, ndërkohë që duhet ta kenë të lehtë. Imagjinoni, ai vjen nga Norvegjia, kur, sa del nga dera e shtëpisë hyn në metro, dhe lëviz jo vetëm në Oslo, por në të gjitha drejtimet me transport publik. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë? Mendoj se e kemi mundësinë që ta thyejmë këtë raport, që është vendosur prej shumë vjetësh dhe që vazhdon të jetë po i tillë në buxhetin e shtetit: 5% investime kapitale dhe pjesa tjetër shpenzime korrente. E thashë edhe

paradite që kemi bërë shumë mirë që i rrisim pagat, se këtu ka para boll për pagat, por pyetja që kam, e cila lidhet edhe me shqetësimin tim, ka të bëjë me faktin: sa eficiente janë këto para që po japim në administratën publike? Sa e përmirësojnë këto para qeverisjen? Sa ide të reja, energji komplet tjetër sjellin këto para në qeverisje? Sepse ndonjëherë mendohet se qeverisja janë vetëm Kryeministri, ministrat, deputetët e kështu me radhë, por harrojmë se qeverisje është edhe administrata publike që duhet të përmbushë funksionet e saj. Këtu tani vlen ajo që ju thashë paradite: rezultatet. Mendoj që kemi shumë njerëz në administratën publike; është e fryrë edhe administrata publike qendrore, edhe vendore, në raport me rezultatet, gjithmonë në raport me rezultatet. Nëse do të ketë rezultate, është histori tjetër, por me këto rezultate që kemi, kemi shumë njerëz. Mendoj që këto paga që po caktojmë tani për administratën publike, duke përjashtuar mësuesit, mjekët, infermierët, edukatorët, ushtarakët, policët e të tjerë me radhë, do ta rrisin presionin për t'u punësuar në administratën publike dhe ne nuk duhet ta ushqejmë këtë gjë. Po, ne duhet të ushqejmë garën për të hyrë në administratën publike, por ne nuk duhet të ushqejmë parazitizmin në administratën publike. Në rast se jemi në parazitizëm, duhet të shkurtojmë, sepse parazitët nuk i duhen kurrkujt, sidomos, patjetër që vlen konkurrenca midis sektorit publik dhe atij privat, por jo në një kah, që të ikin nga sektori privat dhe të vijnë në sektorin publik. Këto rroga që po vendosim në sektorin publik, duhet që patjetër ta konkurrojnë privatin, por ta konkurrojnë në cilësi, jo thjesht për të ikur nga privati dhe për të gjetur rehatin në shtet; duhet ta kuptojnë që në shtet nuk ka rehat. Në shtet duhet të ketë vetëm rezultate, sepse puna mbahet vetëm me rezultat, pa gjë tjetër. Nëse apeloj që të thuhet ky raport midis shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale, patjetër që një element është edhe shkurtimi.

Shqetësimi tjetër që kam, që është shumë i rëndësishëm, kemi shumë para te shtylla sociale. Pyetja është: sa eficiente janë? Kemi 8 milionë euro për pagesë papunësie. Pse? Çfarë zgjidhin këta 8 milionë euro pagesë papunësie? Nëse ne do t'u jepnim prioritet të drejtave të punëtorit, nëse ne do t'i jepnim prioritet kontratës, që sot thuhet nuk ekziston në marrëdhënie midis punëtorit dhe privatit, patjetër që punëtori do të ishte i mbrojtur në një rast pushimi nga puna nga ajo kontratë, do të ishte i mbrojtur edhe për 2 vjet, siç thotë Kodi i Punës në këtë vend dhe nuk ishte fare nevoja për këta 8 milionë që kemi. Tani, nuk mund të zgjidhim probleme që vijnë nga paligjshmëria e një marrëdhënie me paratë e buxhetit të shtetit. Jo, ne duhet të zgjidhim ligjshmërinë në marrëdhënien midis punëtorit, sipërmarrësit dhe ndërmarrjes. Kemi një mal me lekë për ndihmën ekonomike. Ndërkohë që në anën tjetër si për pagesën e papunësisë, si

për ndihmën ekonomike kemi përballë një treg pune që ka uri. Të shkosh në një dyqan peshku në mes të Tiranës dhe të gjesh nga Bangladeshi që punojnë atje, ky është tmerr. Mendoj që ndihmën ekonomike duhet ta marrin tërësisht ata që janë të pamundur për të punuar; duhet ta marrin ndihmën ekonomike ata që nuk kanë mundësi fare që të punojnë; nuk kanë asnjë lloj mundësie, si një nënë e vetme, e ve, me 3 fëmijë në shtëpi që ose duhet të merret me fëmijët, ose duhet të shkojë të punojë, po, kjo duhet ta marrë ndihmën ekonomike, por nuk duhet ta marrë ndihmën ekonomike një që nuk do të punojë dhe del aty pastaj të shfaqet përballë dhe të thotë: “Çfarë më jep ti mua? 60 mijë lekë më jep”. Ti i thua: “Po të jap një rrogë 400 mijë lekë në muaj, jo 60 mijë lekë. “Po çfarë pune kam unë me rrogën, pse atë punë do të bëj unë? Unë dua ndihmën ekonomike!”. Kjo histori duhet të marrë fund. Kemi 10 vjet që e themi këtë gjë, pavarësisht se jemi në nevojë për punëtorë në të gjithë sektorët. Po ju përmend vetëm bujqësinë: sot bujqësia paguan 20 mijë lekë për ditë pune dhe me 3 ditë pune bëhet ndihma ekonomike. Po flas për fshatin, për bujqësisë. Imagjinoni sektorët e tjerë të ekonomisë kombëtare. Tani duhet t’i japim zgjidhje kësaj gjëje. Ato para atje mund të bëhen fare mirë investime publike; mund të hapen vende të reja pune, që këta njerëz mos të jenë në ndihmë ekonomike, por të shkojnë atje; mund të hapen shkolla të tjera profesionale, pse jo, nga një shkollë profesionale për çdo bashki, sidomos për bashkitë e vogla, siç është kjo që përfaqësoj unë, që përfaqëson Antoneta apo të tjerë kolegë që janë këtu, që e kanë të domosdoshme një shkollë profesionale, pra mund të hapet një shkollë profesionale me ato para dhe ata njerëz, ato familje që janë me ndihmë ekonomike mund t’i çojmë të punojnë, pasi u japim zanat. Kjo është shumë e thjeshtë.

Kemi shumë para te skema e ilaçeve. Nga njëra anë u themi pensionistëve: “Ne ua rimbursojmë ilaçet”, por nuk funksionon. E dinë të gjithë që nuk funksionon. Ashtu do ta mbajmë përsëri, që ajo skemë të ushqejë korrupsionin me recetat e ilaçeve, siç e ka ushqyer? Ne kujtohemi që ajo skemë s’funksionon sa herë prokuroria zbardh ndonjë miniskemë të tillë brenda skemës së rimbursimit dhe çon zyrtarë e biznesmenë në burg. Por jo, duhet ta zgjidhim edhe këtë gjë. U kam kërkuar pararendësve, ministrave që kanë ardhur në Komisionin e Ekonomisë: bëni një analizë se sa funksion skema e ilaçeve. Asnjëri nuk kthen përgjigje. Por tani duhet bërë, sepse mund të vlejë shumë më tepër që ato para t’ua japim pensionistëve me pensionin e tyre dhe pensionistët të zgjedhin barin që u duhet; barin që u bën punë, jo atë që i detyrojmë ne. Pra, ka shumë para. Ajo që na duhet ne tani, është efienca e këtyre parave, se për këtë punë jemi, edhe qeveria për këtë punë, është që të bëjë që çdo lekë që shpenzohet në buxhetin e shtetit, të

ketë duk, të ketë produkt një investim publik, një shërbim të përmirësuar dhe natyrisht të jetë një mbrojtje sociale, por mbi të gjitha punësim. Nuk rron njeriu me ndihmë ekonomike. Ajo ndihmë do t'i mbrojë sa do t'i mbrojë atë nevojtarë. Njeriu jeton me punë dhe, natyrisht, duhet të bëjmë çfarë është e mundur që shpenzimet e buxhetit të shtetit të ndihmojnë punën. Nuk mund të jetë e gjithë puna 1,3 miliardë euro që ka buxheti i shtetit si investime kapitale, por ata 1,3 miliardë lekë mund të nxisin, mund të hyjnë në një efekt multiplikativ, i cili bën të mundur që të ketë punë edhe për njerëz të tjerë, sidomos për këta që janë me ndihmë ekonomike.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, nëse nuk ka asnjë koleg gjë tjetër për të shtuar, doja të falënderoja ministrin, relatorët, deputetët për debatin!

Ndërkohë, ju bëj me dije se kemi lënë nesër një mbledhje në orën 09:30 në lidhje me buxhetin faktik, si dhe një mbledhje tjetër në orën 15:00 për deficitin dhe për borxhin.

Rishihemi nesër.

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretare e Komisionit
Enslemvera Zake**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ
Elvi Prifti**